

PYETJET ME TE SHPESHTA PER SHKOLLAT CHARTER

1. Çfarë janë shkollat Charter?

Shkollat Charter janë shkolla publike, por që veprojnë në mënyrë të pavarur. Këto shkolla janë krijuar që të ofrojnë më shumë mundësi për nxënësit në realizimin e objektivave mësimore. Shkollat charter veprojnë si organizata jo fitimprurëse dhe jo fetare, që janë autorizuar nga Bordi i Edukimit. (Drejtoria e Shkollave Charter). Çdo shkollë Charter ka Bordin dhe Personelin administrativ, që vepron si institucion mësimor i pavarur nga Drejtoria Arsimore e Filadelfias. Akti i Shtetit të Pensilvanisë Nr 122 i vitit 1997, krijon mundësinë që shkollat Charter të veprojnë të lira nga kërkesat mësimore lokale dhe shtetërore, të cilat aplikohen rëndom në shkollat publike. Shkollat Charter veprojnë në liri nga shumë mandate mësimore, me përjashtim të atyre që përmbajnë çështje të mosdiskriminimit, shëndetit, sigurisë dhe përgjegjshmërisë. Shkollat charter punësojnë vetë mësuesit e tyre, përpilojnë programin mësimor , zgjedhin tekstat dhe materialet e tyre mësimore, përcaktojnë orarin e ditës shkollore dhe vitin mësimor, përcaktojnë aktivitetet e tyre jashtëshkollore dhe çështje të tjera.

2. Si mund të regjistroj fëmijën tim në shkollë charter?

Meqenëse shkollat charter veprojnë të pavarura nga Drejtoria Arsimore e Filadelfias dhe nga shkollat e tjera charter, me përjashtime të pakta, ju duhet të kontaktoni drejtëpërsëdrejti keto shkolla. Një listë e shkollave charter është e përfshirë këtu.

3. Si mund të transferoj fëmijën tim nga njëra shkollë charter në një tjetër?

Ju nuk mundeni të bëni transferim. Çdo shkollë charter është një njësi e veçantë (LEA- Local Education Agency) e Edukimit Lokal; çdo shkollë charter është e pavarur nga Drejtoria Arsimore e Filadelfias, si edhe prej çdo shkolle tjetër charter, *me përjashtim* të atyre shkollave charter që janë në funksionim nga i njëjti operator, në Filadelfia nuk ka “sistem” të shkollave charter. Prindërit duhet të aplikojnë në secilën shkollë charter që janë të interesuar. Ju mund të kontaktoni drejtorinë e shkollës charter, për informacionin e kontaktit të shkollës. Drejtoria e Shkollave Charter, nuk e lehtëson pranimin në shkollën charter.

4. Kush është përgjegjës për veprimet e shkollës charter, ose të punësuarve të saj; Shkolla Charter, apo Drejtoria Arsimore e Filadelfias?

Si një shkollë e pavarur që funksionon me fondet publike, çdo shkollë charter ka Bordin e saj të Kujdestarisë. Në përputhje me Ligjin e Shkollave Charter (Akti i Shtetit të Pensilvanisë Nr 122 i vitit 1997)” shkolla charter vepron si organizatë jo fitimprurëse dhe jo fetare, që është përgjegjëse e vetme ligjore për ndonjë dhe të gjitha dëmet, që vijnë si rrjedhojë e veprimeve që përfshijnë shkollën charter.”

5. Bordi i shkollës charter bën takime të përmuajshme. A janë këto takime të hapura për publikun?

Po. Synimi i shumicës së shkollave charter është t’i afrojnë shkollat me prindërit dhe komunitetin të cilit i shërben dhe të ofrojnë mirëseardhjen për pjesëmarrjen e komunitetit. Meqenëse shkolla charter është një institucion publik, që financohet me fondet e taksapaguesve, shkolla është subjekt i një ligji të quajtur “Sunshine Law”. Ky ligj (që aplikohet në të gjitha institucionet publike), citon që të gjithë qytetarët kanë të drejtë të njoftohen për ndjekjen e takimeve kur Bordi kryen biznes. Ligji

“Sunshine” gjithashtu i jep të drejtë qytetarëve të diskutojnë në takimet e hapura të Bordit të shkollës charter.

Nëse ju jeni të interesuar të ndiqni, ose të diskutoni në një takim, ju duhet të kontaktoni shkollën charter për planin e takimeve të Bordit; Secila shkollë charter duhet të ketë planin vjetor të takimeve të Bordit të afishuar në shkollë. Ju gjithashtu duke kontaktuar shkollën charter, mund të merrni edhe një listë të pjestarëve të Bordit.

6. Shkolla Charter më ka kërkuar të ndjek takimin e përmuajshëm me prindërit gjatë ditëve të shkollës. Çfarë problemi sjell nëse nuk e ndjek këtë takim?

Shumë prej shkollave charter ofrojnë mundësi për përfshirjen e prindërve dhe komunitetit në veprimtarinë e shkollës. Sidoqoftë, shkollat charter nuk mund të imponojnë kërkesa ndaj prindërve që mund të jenë si pagesa për shërbimet bazë mësimore (p.sh që prindërit të punojnë “vullnetarisht” një numër të caktuar orësh në mënyrë që fëmija të regjistrohet, ose të vazhdojë shkollën charter). Nëse ju keni pyetje për politikën e shkollës që ndjek fëmija juaj, ju duhet t’i adresoni te CEO i shkollës, dhe/ose Bordi i Kujdestarisë (Board of Trustees).

7. Pse unë shoh edhe mësues të Drejtorisë Arsimore në shkollat charter?

Mësuesit e Drejtorisë Arsimore duhet të marrin leje nga shkolla që të mund të punojnë në shkollat charter. Këta mësues duhet të plotësojnë kërkesat e përzgjedhjes të shkollës charter, që të mund të punojnë aty.

8. Si mund të regjistroj fëmijën në një shkollë charter virtuale?

Familjet duhet të shohin listat e shkollave charter virtuale dhe pastaj të kontaktojnë individualisht këto shkolla për informacion shtesë. Nëse edhe pas kësaj ka paqartësi rreth regjistrimit, kontaktoni **Marlene Kanuck** në numrin e telefonit # 717-783-9294

9. Si duhet të veprojmë nëse shkolla nuk më ofron një sport të cilin Unë dëshiroj t’a ushtroj?

Ju përsëri mund t’a ushtroni këtë sport në shkollat e Drejtorisë Arsimore. Ligji i Shkollave Charter (Akti i Shtetit të Pensilvanisë Nr 122 i vitit 1997) e mundëson ushtrimin e aktiviteteve jashtëshkollore për nxënësit e shkollave charter. Ju duhet të kërkonit për ekipin që dëshironi dhe nga ana tjetër të plotësoni kushtet për pjesëmarrje (oraret e stërvitjeve, udhëtimet për ndeshjet etj.) Politikën e Drejtorisë përcaktojnë se si ju mund të luani në ekipet e shkollave pranë shkollës tuaj charter, ose në shkollën e zonës tuaj. Nga ana tjetër mund të ketë edhe pagesa për aktivitetet jashtëshkollore.

10. A do të ketë mbrëmje mature (Prom) në shkollat charter?

Ndoshta. Shkollat charter i hartojnë vetë kalendaret e tyre, programet mësimore dhe aktivitetet e nxënësve. Shumë prej programeve të shkollave të mesme ofrojnë një gamë të gjërë të aktiviteteve të nxënësve- shumë prej tyre tradicionale , por edhe aktivitete të reja.

11. A u mundësohet nxënësve të shkollave charter të marrin pjesë në Korin dhe Orkestrën e Qytetit?

Po, nëse ju plotësoni kushtet e pranimit. Përsëri e theksojmë se nxënësve të shkollave charter u lejohet pjesëmarrja në aktivitetet jashtëshkollore.

12. A do të kem mundësi që të kaloj në një shkollë të mesme me Pranim Special, nëse kam studjuar në një shkollë charter?

Po, nëse plotësoni kërkesat e pranimit. Nxënësit e shkollave charter janë të inkurajuar të ndjekin EXPO e shkollave të mesme, kur ata janë në klasën e 7_të dhe të 8_të. Këshilltarët e shkollave charter marrin shumë kopje të Aplikimeve dhe Broshurave të shkollave të mesme. Nxënësit e shkollave charter janë të lirë të aplikojnë për çdo shkollë të mesme publike charter, në shkollat e Drejtorisë Arsimore, ose në shkollat virtuale (të autorizuar nga Departamenti i Edukimit të Pensilvanisë).

13. A do të ndikojë të qëniti në shkollë charter, që fëmija im të vazhdojë në një shkollë të lartë të mirë?

Ndjekja e shkollës charter nuk e garanton pranimin në kolegji. Çdo nxënës dhe çdo shkollë charter do të matet me shumë faktorë. Le të përmendim disa prej tyre, që janë: 1. Rigoroziteti i rekordeve Mësimore 2. Rezultati në SAT 3. Shtrirja e aktiviteteve jashtëshkollore 4. Cilësia e shkrimit të nxënësit 5. Cilësia dhe forca e rekomandimeve të pjestarëve të personelit, etj.

Keni pyetje të tjera? Na kontaktoni në: www.philasd.org/language/albanian/help